



Tiranë, më 9 Maj 2023

## NJOFTIM PËR SHTYP

### Krijohet Platforma Kombëtare e Shoqërisë Civile për Integrimin Evropian: Fëmijët dhe të Rinjtë

Tiranë, 9 Maj 2023 – Shtatë organizata për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, sot në 9 Maj - Dita e Europës, shpallën krijimin e Platformës Kombëtare të Shoqërisë Civile për Integrimin Evropian për Fëmijët dhe të Rinjtë. Platforma është një iniciativë e CRCA/ECPAT Shqipëri, së bashku me ALO116 Shqipëri, MEDPAK, Save the Children në Shqipëri, SHKEJ, Terre des Hommes dhe World Vision në Shqipëri.

*“Pas disa muajsh pune intensive, sot shpallim një ndër përpjekjet më serioze të shoqërisë civile, për të mbështetur Shqipërinë dhe autoritet për të avancuar në procesin e integritimit në BE, duke vendosur interesat e fëmijëve dhe të rinjve në qendër të këtij procesi” – tha Altin Hazizaj, nga CRCA/ECPAT Shqipëri.*

Platforma synon të nxisë bashkëpunimin, angazhimin dhe kontributin e sektorit të shoqërisë civile të cilët punojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në procesin e negociatave për integrimin evropian të Shqipërisë. Platforma synon po ashtu pjesëmarrjen e shoqërisë civile, fëmijëve dhe të rinjve, në këtë proces transformues, si dhe nxitjen e transparencës së institucioneve përkundrejt qytetarëve dhe shoqërisë.

*“Platforma Kombëtare e Shoqërisë Civile për Integrimin Evropian: Fëmijët dhe të Rinjtë, është e gatshme të mbështesë Shqipërinë në procesin e negociatave me BE-në, si në aspektin e përafërimit të legjislativ, ashtu edhe të praktikave më të mira për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të rinjve” – tha Anila Meço, nga Save the Children Shqipëri.*

Platforma ka përcaktuar gjashtë objektiva kryesore për punën e saj, ndërkohë që do të jetë e hapur për kontributin dhe pjesëmarrjen e të gjitha OSHC-ve të fëmijëve dhe të rinjve anëmbanë Shqipërisë, që duan të mbështesin kauzën e fëmijëve dhe të rinjve gjatë negociatave për integrimin në Bashkimin Evropian.

*“Çelja e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian është një hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit të vendit në BE. Në këtë kuadër, ne vlerësojmë dhe përgëzojmë hapat pozitivë që Shqipëria ka ndërmarrë në përmbushjen e kushteve për hapjen e negociatave. Ky proces nënkupton një transformim themelor ligjor, shoqëror dhe administrativ, ndaj roli që shoqëria civile luan në të është i një rëndësie të veçantë” – tha Eljona Boçe, nga World Vision në Shqipëri.*

Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve zënë një vend tepër të rëndësishëm në shumë prej kapitujve të Acquis, ndaj angazhimi dhe kontributi i OSHC-ve të sektorit, si dhe vetë fëmijëve dhe të rinjve, në këtë proces transformues është kyç për të siguruar pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimarrëse, fuqizimit të demokracisë dhe transparencës së institucioneve përkundrejt tyre.

*"Si përfaqësuese e një organizate, por edhe si prind, jemi të gatshëm të sjellim perspektivën e aftësisë së kufizuar për aksesueshmerinë dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuar për përafrimin e legjislacionit tonë me direktivat e BE-së, në fokus aftësinë e kufizuar."* - tha Zela Koka, nga Shoqata MEDPAK.

Platforma e Shoqërisë Civile për Integrimin Europian: Fëmijët dhe të Rinjtë, ka si qëllim, ndër të tjera, të mbështesë dhe të kontribuojë në Platformën e Partneritetit për Integrimin Europian të ngritur nga Qeveria shqiptare dhe që funksionon në bazë të tryezave të kapitujve respektivë të negociatave, pranë Ministrive dhe institucioneve kryesore.

*"Ne ftojmë të gjitha institucionet publike në Shqipëri, sidomos Ministrinë që udhëheqin kapitujt specifikë në procesin e negociatave, që të përdorin të gjithë bagazhin e dijeve dhe të ekspertizës mbi 30 vjeçare të OSHC-ve për të punuar dhe përmirësuar së bashku situatën e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve në vend, në përputhje me detyrimet që lindin nga procesi për anëtarësimin në BE"* – tha Enkelejda Kallçiu, nga Terre des Hommes Shqipëri.

Disa nga angazhimet kryesore të Platformës janë:

- **Pjesëmarrja në tryezat e diskutimit sipas kapitujve**, duke kontribuar në mënyrë pro-aktive në mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe interesave të tyre në procesin e negociatave të Shqipërisë me BE-në;
- **Informimi i fëmijëve dhe të rinjve, institucioneve publike si dhe shoqërisë civile mbi procesin e negociatave**, procesin e integritetit europian dhe ndikimin e tyre në të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve;
- **Përgatitja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit mbi situatën e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri**, përputhshmërinë e legjislacionit vendas me atë të BE-së, politikën shtetërore dhe masat që ka ndërmarrë Qeveria për përmirësimin e politikave dhe shërbimeve në përputhje me standardet e BE-së;
- **Dhënia e propozimeve dhe rekomandimeve për të përmirësuar ligjet, politikat dhe standardet** në mbrojtje dhe në ushtrim të të drejtave për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri;

Më 19 Korrik 2022, mbledhja e parë ndërqeveritare hapi procesin e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Gjatë kësaj kohe palët janë angazhuar në procesin e njohjes reciproke (screening) ku institucionet vendase dhe të BE-së u ftuan të paraqesin informacion të përditësuar në lidhje me gjendjen aktuale dhe përputhshmërinë e legjislacionit të Shqipërisë me ato të BE-së. Përfundimi i procesit, që pritet të ndodhë gjatë mesit të këtij viti, përcakton edhe punën, përpjekjet dhe kohëzgjatjen që do t'i duhet vendit tonë për të negociuar 35 kapitujt e *Acquis*.

\* \* \*

**Kontakti për median**

(për pyetje / kërkesa për intervista etj.):

Altin Hazizaj, [altin.hazizaj@crca.al](mailto:altin.hazizaj@crca.al) / 0675002025

**Kontakti për shoqërinë civile:**

E-mail: [platformaeu@crca.al](mailto:platformaeu@crca.al)